



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: Takim i z. Behgjet Pacollit me Ambasadorin Spanjoll

Prishtinë, 30 nëntor 2007

Njoftim për media

Të nderuara media,

Kryetari i AKR-se z. Behgjet Pacolli priti në një takim zyrtar në selinë e partisë, Ambasadorin e Spanjës në Beograd, z. Jose Riera Siquier

Pas këtij takimi Lideri i AKR-së z. Behgjet Pacolli, tha se kishin biseduar me Ambasadorin Spanjoll për shumë çështje. Ndër to edhe për pavarësinë e Kosovës dhe mbështetjen që duhet t'i jap Spanja proceseve në Kosovë, si dhe definimit të statusit të vendit tonë. **“Kërkova nga z. Siquier që Spanja ta mbështes Kosovën, veçanërisht në këtë fazë dhe ti kontribuoj, sidomos zhvillimit të ekonomisë së Kosovës” – z. Pacolli.** Lideri i AKR-së shtojë se Spanja është model i një shteti të zhvilluar dhe të integruar, prandaj kemi çfarë të mësojmë dhe të marrim shembull nga ky vend.

Ndërkaq Ambasadori Spanjoll, z. Jose Riera Siquier, shprehi bindjen e tij se Spanja do të vazhdoj bashkëpunimin me Kosovën edhe në të ardhmen dhe se janë të interesuar për një Kosovë që do ti kontribuojë paqes në Rajon. **“ Ne do të mundohemi që sa më shumë të mbështesim proceset në Kosovë, në të gjitha nivelet. Veçanërisht Spanja është e interesuar që nivelin e bashkëpunimit të ngjis edhe në rrafshin ekonomik në të ardhmen”**-tha ai.

Sa i përket qëndrimit të Spanjës, për çështjen e statusit të Kosovës, z. Riera Siquier, u shpreh se Spanja është duke pritur përfundimin e disa proceseve të nisura rreth definimit të statusit të Kosovës, që pastaj të dal me një qëndrim të qartë se i përket kësaj çështje.

Zyra për Informim e AKR-së